

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjykatësit: Gëzim Llulluni kryetar, Isa Kelmendi dhe Albert Zogaj anëtarë, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditësit M.M. nga..., të cilin e përfaqëson A.K., avokat, kundër të paditurit Fondi i Garancisë së Kosovës, tani Byroja Kosovare e Sigurimit nga Prishtina, të cilën e përfaqëson D.P. jur. i dipl. dhe T.Xh. juriste e diplomuar, për shkak të kompensimit të dëmit jo material dhe material, vlera e kontestit 23.750,00 €, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, e paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë-Dega në Rahovec, C.nr.367/10 të dt. 04.07.2013, në seancën e kolegjit e mbajtur me dt. 19.09.2016 mori këtë

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pa bazuar ankesa e të autorizuarit të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimit, me seli në Prishtinë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë-Dega në Rahovec, C.nr.367/10 i dt. 04.07.2013, VËRTETOHET.

NDRYSHOHET aktgjykimi i atakuar vetëm në pjesën e dispozitivit, që ka të bëjë me llogaritjen e kamatës, ashtu që, gjykohet si vijon: me kamatë e cila vlen si për mjetet e deponuara në bankat komerciale që operojnë në Kosovë, në afat më tepër se 1 (një) vit pa destinim të caktuar, duke filluar nga data e marrjes së aktgjykimit në shkallë të parë, datë 04.07.2013 e deri në pagesën definitive.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e atakuar të gjykatës së shkallës së parë pjesërisht APROVOHET kërkesë padia e paditësit në mënyrë si vijon: DETYROHET i padituri Fondi i Garancisë së Kosovës, tani BKS, Byroja Kosovare e Sigurimeve, me seli në Prishtinë, që paditësit M.M., t'ia bëjë kompensimin e dëmit të pësuar në aksidentin e komunikacionit rrugor, i cili ka ndodhë me datë 12.07.2010, dhe atë

Në emër të dëmit jo material:

- Për dhimbje fizike shumë prej..... 3.500,00 euro
- Për frikën shumë prej..... 1.500,00 euro
- Për zvogëlimin e aktivitetit jetësor shumë prej 1.000,00 euro
- Për shëmtim truporë shumë prej 500,00 euro

Në emër të dëmit material:

- Për kujdesin dhe ndihmën e huaj shumë prej 100,00 euro
- Për ushqim që përforcuar shumë prej 150,00 euro
- Për dëmtim të gardërobës shumë prej..... 100,00 euro

Për të gjitha kriteret shumë e përgjithshme prej 6.800,00 euro, me kamatë ligjore në lartësi prej 4.5 %, të llogaritur nga dita e dorëzimit të padisë, respektivisht nga data 31.12.2010, deri të pagesa definitive. Të gjitha këto shumat i padituri është i obliguar që të i paguaj në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë të aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Përtej shumës së aprovuar kërkesë padia e paditësit e precizuar, në pjesën tjetër refuzohet.

Me të njëjtin aktgjykim obligohet i padituri që paditësit t'ia paguaj edhe shpenzimet proceduralë në shumë prej 1.206,00 euro, po ashtu në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor ka paraqit ankesë i autorizuari i të paditurës, për shkak të cenimit të rëndë të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aktgjykimi i atakuar të priset dhe lënda të kthehet në rivendosje apo të ndryshohet ashtu që në pjesën e gjykuar lartësitë të zvogëlohen dukshëm më ulët, duke u bazuar në nenin 195.1 pika e) e LPK-së.

Gjykata e Apelit e Kosovës, aktgjykimin e atakuar e shqyrtoi në pajtim me dispozitat e nenit 194 të LPK-së dhe pas vlerësimit të thënieve ankimore, gjeti se:

Ankesa e të autorizuarit të paditurës, është e pa bazuar

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se: Paditësi në aksidentin e komunikacionit i cili ka ndodhë me dt.12.07.2010 ka pësuar lëndime të rënda trupore, ndërsa shkaktari i aksidentit ka qenë M.LL., i cili ka drejtuar automjetin i cili ka qenë i pa regjistruar dhe i pa siguruar. Shkaktuesi i aksidentit është shpaluar fajtor me aktgjykimin penal të Gjykatës Komunale në Prishtinë dhe është dënuar. Ka kërkuar nga gjykata që kërkesëpadia e precizuar e paditësit me dt.13.05.2013 të aprovohet në tërësi si e bazuar dhe ka kërkuar edhe shpenzimet procedurale.

Ndërkaq, përfaqësuesi i të paditurës e ka kontestuar pjesërisht kërkesë padinë e paditësit, duke konsideruar se edhe paditësi ka kontribuar që të vijë deri te aksidenti, ndërsa lartësinë e precizimit të kërkesë padisë e ka konsideruar si shumë të lartë, në krahasim me lëndimet e pësuar. Gjatë procedurës i autorizuari i të paditurit nuk e ka kontestuar bazën juridike të kërkesë padisë, por vetëm larësin e saj.

Gjykata e shkallës së parë, pas administrimit të provave dhe vlerësimit të tyre konform dispozitës së nenit 8 të LPK-së, ka vërtetuar gjendjen faktike se, baza juridike e kërkesë padisë nuk është kontestuar nga e paditura, ndërsa me aktgjykimin penal të Gjykatës Komunale në Prishtinë P.nr.2065/2010, të datës 28.05.2010 shkaktuesi i aksidenti është shpallur fajtor dhe është dënuar. Me që baza juridike nuk ishte kontestuese lartësinë e saj gjykata e ka vërtetuar me ekspertiza mjekësore, sipas që cilave ka rezultuar se lëndimet e pësuar të paditësit karakterizohen si lëndime të rënda trupore, të cilat i kanë shkaktuar të njëjtit dhimbje fizike të cilat ekspertët i kanë konstatuar si posaçërisht të rënda në kohëzgjatje prej 1.30 min, intensitetit të lartë dy ditë dhe intensitetit të mesëm 28 ditë, ndërsa intensitetit të ulët i ka edhe sot e kësaj dite. Sipas ekspertëve të paditësi ekziston zvogëlimi i aktiviteti të përgjithshëm jetësor në shkallën prej 6.5 % për shkak të humbjes së katër dhëmbëve, thyerjes së brinjës së gjashtë e anës së djathtë të kraharrorit. Sa i përket shëmtimit trupor te paditësi është konstatuar i shkallës së lehtë, me përshkrim si në ekspertizë. Ndihma e huaj ka qenë e nevojshme 30 ditë, kurse ushqimi i përforcuar 42 ditë. Ndërkaq, rehabilitimi fizioterapeutik ka qenë i nevojshëm në kohëzgjatje prej 30 ditësh, brenda dy viteve pas aksidentit.

Gjithashtu, edhe eksperti psikiatër ka konstatuar se paditësi në momentin e aksidentit ka përjetuar frikë primare, në formë të frikës nga vdekja, e cila ka zgjatur disa sekonda, pastaj frikën sekondare e intensitetit të lartë dhe intensitetit të mesëm në kohëzgjatje të përshkruar si në ekspertizë. Gjykata e shkallës së parë si bazë për zgjidhjen e këtij kontesti e ka marr faktin se baza e kontestit nuk është kontestuar, ndërsa nga ana e të paditurit është ofruar kompensimi përkatës në procedurë jashtë gjyqësore, për të cilën nuk është pajtuar paditësi.

Këtë gjendje faktike të çështjes gjykata e shkallës së parë e ka bazuar në dispozitat e nenit 154, 178 të LMD-së, si dhe nenit 319 dhe 452 të LPK-së, dhe ka vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar.

Nisur nga një gjendje e tillë e vërtetuar faktike e çështjes, Gjykata e Apelit vlerëson, se dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është i kuptueshëm dhe i përshtatshëm për përmbardim, nga se në arsyetimin e aktgjykimit të atakuar janë paraqitë arsye të plota dhe të kuptueshme për faktet me rëndësi vendimtare, për gjykimin e drejtë të kësaj çështje kontestimore, se ky aktgjykim nuk përmban shkelje esenciale nga dispozitat e nenit 182 par.2 pika k) dhe n), si dhe nenit 322 të LPK-së, as zbatim të gabuar të së drejtës materiale nga dispozita e nenit 190 dhe 200 të LMD-së, sikurse pa të drejtë pretendohet në ankesën e të autorizuarit të paditurës, e as shkelje tjera esenciale për të cilat gjykata e shkallës së dytë është i detyruar që të kujdeset sipas detyrës zyrtare komfor dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Po ashtu nuk qëndron pretendimi ankimor se, gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes nuk ka vërtetuar gjendjen faktike duke ju referuar ekspertizës së komunikacionit duke vlerësuar saktësisht kontributin dhe përgjegjësin eventuale të pjesëmarrësve në aksident, sepse nga vet fakti se nga ana e të paditurës nuk është kontestuar baza e kërkesë padisë, por janë kontestuar vetëm lartësitë, atëherë në situata të tilla ekspertiza e komunikacionit është e pa nevojshme dhe relevante për të ndikuar në vendosjen meritore të kontestit. Se e paditura nuk e ka kontestuar bazën e kërkesë padisë shifet nga procesverbali i shqyrtimit kryesorë të datës 04.07.2013.

Sa i përket shumave që kanë të bëjnë me ndihmën dhe kujdesin e huaj, ushqimin e përforcuar si dhe dëmtimin e gardërobës të gjitha këto gjykata i ka caktuar bazuar në ekspertimet mjekësore të ekspertëve të caktuar nga gjykata e shkallës së parë të cilët i kanë konsideruar të nevojshëm ndihmën e huaj, ushqimin e përforcuar dhe rehabilitimin fizioterapeutik të cilat gjykata i ka gjykuar bazuar në praktiken gjyqësore të gjykatave të Kosovës për situata të tilla.

Ndërkaq, sa i përket pretendimit ankimor për caktimin e lartësisë së dëmit të shkaktuar, ku sipas të autorizuarit të paditurës janë caktuar shumat tepër të larta, përsëri është pretendim i pa bazuar, sepse gjykata e shkallës së parë të gjitha shumat e caktuara për të gjitha llojet e dëmit, i ka bazuar në ekspertimet përkatëse mjekësore si dhe praktikën gjyqësore e cila aplikohet në Gjykatat e Kosovës kohëve të fundit. Ndërkaq, lidhur me lartësitë e dëmit të caktuar nga gjykata e shkallës së parë për paditësin i cili në cilësi të këmbësorit ka pësuar aksident trafiku Gjykata e Apelit i vlerësoi si reale e të cilat sa do pakë do të jenë si satisfaksion për zvogëlimin e dhimbjeve të përjetuara nga paditësi.

Me dispozitën e nenit 154 të LMD-së është përcaktuar se: kush i shkakton tjetrit dëmin ka për detyrë ta kompensoi, në çoftë se nuk provon se dëmi la lindur pa fajin e tij. Ndërkaq, me dispozitën e nenit 178 të LMD-së është përcaktuar zbatimi i rregullave mbi përgjegjësin në bazë të fajësisë. Pastaj, për dhimbjet e pësuar fizike për personin që ka pësuar në aksident i parasheh dispozita e nenit 200 të LMD-së.

Gjykata e Apelit, vlerëson se në bazë të gjendjes së tillë të çështjes, i pranon konstatimet faktike dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, duke qenë se gjendjen faktike e ka vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, e mbi këtë bazë drejtë i ka zbatuar dispozitat e të drejtës materiale, kur ka vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar.

Mirëpo, qëndron pretendimi ankimor lidhur me llogaritjen e kamatës, kështu që në këtë pjesë gjykata aktgjykimin e atakuar e ndryshoi, duke gjykuar shumën e dëmit të pësuar tek paditësi për të gjitha lartësitë e dëmit, me kamatë e cila vlen si për mjetet e deponuara në bankat komerciale që operojnë në Kosovë, në afat më tepër se 1 (një) vit pa destinim të caktuar, duke filluar nga data e marrjes së aktgjykimit në shkallë të parë, datë 04.07.2013 e deri në pagesën definitive.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura, e në pajtim me dispozitat e nenit 200 dhe nenit 195 par.1 pika d) lidhur me pikën e) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr. 3445/2013 më dt. 19.09.2016

KRYETARI I KOLEGJIT-GJYKATËSI
Gëzim Llulluni